



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

"BASHKIA PATOS"

DREJTORIA E MBROJTJES SOCIALE DHE POLITIKAVE TË ARSIMIT

Nr. 2942 / Prot.

Patos, më 29.09 /2025

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në pjesën V "Kontratat" dhe kreu VI "Qiraja" të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 62, datë 26.09.2025 pika 3 "Për miratimin e procedurës për marrjen me qera të një objekti privat në Zharrëz për zhvillimin e procesit mësimor për arsimin fillor të shkollës së bashkuar "Sotir Çapo", bashkia Patos ndodhur në fazën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes së objektit të shkollës "Sotir Çapo", shpall procedurën me objekt **"Marrje me qera të një objekti privat në Zharrëz për zhvillimin e procesit mësimor për arsimin fillor të shkollës së bashkuar "Sotir Çapo"**.

1. Ndërtesa duhet të ketë kushte optimale infrastrukturore.

Ndërtesa të jetë e përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor për ciklin e ulët (klasa 1-5) me një numër prej 58 (pesëdhjetë e tetë) nxënës dhe stafin pedagogjik për një periudhë të parashikuar 8 (tetë) mujore nga nënshkrimi i kontratës. Të jetë ndarë në ambiente përkatëse për pesë klasat dhe pjesën e stafit pedagogjik me jo më pak se 3 tualete, minimalisht 200 m² me qëllim plotesimin e nevojave bazë për zhvillimin e procesit mësimor.

2. Dokument pronësie, kontratë me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe të ketë furnizim me ujë.

3. Vendndodhja e ndërtesës të ketë një distancë jo shumë të largët nga qendra e fshatit Zharrëz, Njesia administrative Zharrëz.

Të interesuarit të paraqesin dokumentacionin e kërkuar pranë bashkisë Patos, brenda datës 13.10.2025, ora 16:00.

Ky njoftim duhet të publikohet në stendat e afishimit publik të bashkisë Patos dhe në faqen zyrtare të institucionit.

KRYETAR
Fation Duro